



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova**

**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**

**Opština Kacanik**

**Municipal Kacanik**

**01Nr.104/02-12471**

**Kaçanik, 14.06.2023**

### **PROCESVERBAL:**

**Konsultim Publik me temë: Korniza Afatmesme Buxhetore ( KAB) 2024-2026**

**Data: 24.05.2023**

**Vendi: Salla e Kuvendit Komunal**

**ora 11.00**

Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa e cila ka hartuar Kornizën Afatmesme Buxhetore ( KAB) 2024-2026, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ ( MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna,, organizoi Konsultim publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore ( KAB) 2024-2026. Fillimisht takimin e hapi Kryetari i Komunës Besim Ilazi, i cili inkurajoi qytetarët që të bëhen pjesë e dëgjimeve dhe konsultimeve publike, ku së bashku edhe vendimmarrja do të ishte më reale. Kryetari edhe më tutje paraqiti nevojën se Kaçaniku si komunë e vogël, ka nevojë për ndihmën dhe mbështetjen e institucioneve qendrore, duke shtuar se përkundër që të gjitha projektet e mëdha komunale që nuk kanë mundur të realizohen me buxhetin komunal, janë përcjellur me kohë në qeverinë e Kosovës, deri më tani nuk është përkrahur asnjë projekt nga niveli qendror.

Nga ana tjetër Bahri Selimi- Drejtor për Buxhet dhe Financa, shpalosi draft Kornizën Afatmesme Buxhetore ( KAB) 2024-2026, për të cilën tha se Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH 2024-2026) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2024. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë, e cila reflekton mjedisin makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Drejtori Selimi tha se buxheti për vitin e ardhshëm parashikohet të jetë afër 12 milion euro, që do të shpërndahet në të gjitha kategoritë buxhetore të shpenzimeve.

**Nexhmedin Lika:** Krytar i fshatit Shtrazw

Kërkoj asfaltimin e një rruge 150 m në Shtrazë.

**Rrustem Zenuni-** Asambleist komunal: Korniza buxhetore ka investime edhe në turizëm, ju përgëzoj, kërkoj investime dhe fokus edhe tek zonat komunale ekonomike, rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellës e kanalizim. Ju përgëzoj për planifikimin e ndërtimit të çerdhes në Kaçanik të Vjetër, të planifikohet rregullimi i çerdheve edhe në Doganaj, Elezaj etj. Ju përgëzoj poashtu për planifikimin e rrugës për të Kulla e Hasanit . Kërkoj rregullim të terreneve sportive në Duraj, ku është hapësira e gatshme.

**Naser Murseli- Kryetar- Këshilli i fshatit Doganaj+Koxhaj (zona8)**

Prioritet trotuari prej Fushës së Pajtimit deri te Pishina Medi dhe tek Ura e “Barovinës”,  
Asfaltimi i rrugës “ Fari Demnika”, dhe rregullimi i përroskës tek varrezat.

**Hasip Salihu- Kryetar- Bajnicë + Semajë (zona 12)**

Rregullimi i rrugës që lidh fshat n Semajë dhe Komunën e Ferizajt, si dhe investime në renovimin e objektit dhe sistemit të ngrohjes të Kompanisë “**Pastërtia**”.

**Kadri Dardhishta-Kryetar- Kaçanik- Këshilli i qendrës urbane, zona I**

Rregullim të rrugës “ Avdurrahim Shehu”

Rruga “ Kjani Bela” është bërë zgjerimi, por është rrugë e dëmtuar

**Fatmir Bunjaku** – asambleist komunal

Të bëhet rregullimi i rekës që lidh fshatin Biqec me fshatin Nikaj

Fadil Vishi- Dubravë

Falënderues për projektet e realizuara, kërkoj që të bëhet rregullimi i trotuarit nga Lumi Lepenc deri tek varrezat e dëshmorëve, rregullimi i rekës së fshatit, një kënd rekreativ për pushues, zgjerim të rrugës “Fetije Qorri”. **Bashkim Krasniqi**- asambleist- fshati Kaçanik i Vjetër është i vetmi fshat që në vazhdimësi mbi popullohet, andaj edhe investimet janë të nevojshme. Të rregullohet shtrati i Lumit Nerodime, së paku tek stacioni i trenit, rregullimi i disa rrugicave.

**Shaban Dubova-qytetar** kërkoj rregullim të infrastrukturës në Fshatin Dërnagllavë.

**Besnik Dema-Kryetar- Këshilli i fshatit Bob (zona 3)**

Te bëhet rregullimi i kanalizimit( në lagjen Kuka).

Të bëhet rregullimi i Prrockes nga shkolla e deri te shtëpia e fundit .Te filloj vazhdimi i përrockes aty ku ka mbet e deri shtëpia e fundit (në lagjen Zeneli).

Te bëhet rregullimi i Kabëzave te betonit( në lagjen Caka)

**Fitore Vishi- asmableiste**

Kërkoj të bëhet zgjerimi i rrugës tek shkolla fillore e fshatit Runjevë, pastrimi i lumit Nerodime, të rregullohet rruga e lagjes “ Miftar”.

**Ziber Luma Kryetar- Këshilli i fshatit Glloboqicë ( zona 20)**

Kërkojmë rregullimin e një fushe sportive.

**Azem Koraqi-Kryetar - Këshilli i fshatit Kovaçec (zona 14)**

Kërkojmë rregullimin e përroskës në fshatin Kovaqec, kërkojmë bashkëfinancim edhe me komunën, si dhe intervenim në rregullimin e kanalizimit në disa shtëpi.

